

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelim të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16, 164/18 dhe 190/19), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 03/2022

Për parashtrim të kërkesës për shfrytëzim të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në Peshkatari dhe Akuakulturë për vitin 2022

I. LËNDA E SHPALLJES PUBLIKE

Lëndë e kësaj shpalljeje është ndarja e përkrahjes financiare për nenpikat për masat në vijim:

Masa 1	Përkrahja financiare në peshkatari	Mjetet	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 1.5	Pikat e peshkimit-ndërtimi i të reja, rikonstruimi dhe adaptimi i pikave ekzistuese të peshkimit, kompensim i shërbimit për shfrytëzim të pikave ekzistuese	1.000.000,00 denarë	1.000.000,00 denarë
Nënpika 1.6	Përkrahje financiare për rehabilitim të ujërave për peshkim me zgjerim, mbindërtim dhe pajisje e kapaciteteve ekzistuese/baseneve për prodhim e materialit riprodhues dhe materialit për kultivimin e peshqve.	1.500.000,00 denarë	1.500.000,00 denarë
Nënpika 1.7	Ndërtimi dhe rikonstruimi mandrave për peshkim tradicional në liqenin e Dojranit	1.000.000,00 denarë	1.000.000,00 denarë

Masa 2	Përkrahja financiare në akuakulturë	Mjetet	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
Nënpika 2.1	Përkrahja financiare për investime në akuakulturë - Ndërtimi i kapaciteteve të reja për akuakulturë - Zgjerim, rekonstruim, adaptim dhe modernizim të kapaciteteve ekzistuese për akuakulturë - Ndërtim i kapaciteteve të reja për kultivimin e peshqve - Furnizim të pajisjes, kultivim, deponim dhe paketim të peshqve	15.000.000,00 denarë	7.000.000,00 denarë për përdorues individual

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë shfrytëzimi të mjeteve kanë subjektet në vijim, edhe atë për nënpikat:

Subjektet	Nënpika
Njësi të vetëqeverisjes lokale për ndërtimin e pikave të reja, rikonstruimin dhe adaptimin e pikave ekzistuese për peshkim, ndërsa shfrytëzues të mjeteve për kompensim për shërbim për shfrytëzim të pikave ekzistuese janë koncesionerë të peshkut.	1.5
Reproqendra të regjistruara për prodhim të materialit reproduktiv dhe materialit për kultivimin e peshqve	1.6
Njësia e vetëqeverisjes lokale ose koncesionerët e peshqve për kryerjen e peshkimit tregtar në Liqenin e Dojranit.	1.7
Shfrytëzues të mjeteve të destinuara për ndërtim të kapaciteteve të reja për akuakulturë janë: Subjektet që janë të regjistruara për aktivitetin e akuakulturës dhe që zotërojnë ose përdorin pronë të patundshme mbi të cilat planifikojnë të ndërtojnë kapacitete akuakulture; ose të kenë leje për përdorimin e ujit për vendosjen e kafazeve në zonat e parapara për akuakulturë	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të destinuara për zgjerimin, rindërtimin, përshtatjen dhe modernizimin e kapaciteteve ekzistuese të akuakulturës janë: Subjektet që janë të regjistruara për veprimtari akuakulture, dhe janë të regjistruar në regjistrin e kultivuesve të peshkut që mbahet nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të destinuara për ndërtimin e kapaciteteve të reja për kultivimin e peshkut janë: Subjekte që janë në rangun e sipërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme të regjistruara për aktivitetin e akuakulturës dhe zotërojnë ose përdorin pronë të patundshme mbi të cilat planifikojnë të ndërtojnë kapacitete përpunimi;	2.1
Shfrytëzues të mjeteve të destinuara për furnizimin e pajisjeve për përpunimin final, përpunimin, ruajtjen dhe paketimin e peshkut janë subjektet që janë në rangun e sipërmarrjeve mikro, të vogla ose të mesme që zotërojnë ose përdorin një objekt të destinuar për përpunimin e peshkut.	2.1

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet dedikohen për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzime të tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të peshkatarisë dhe akuakulturës për vitin 2022 (Gaz.Zyrtare nr. 37/22 dhe 274/22).

Për Masën 2.1, përkrahja financiare paguhet në parim e bashkëfinancimit për investime të përfunduara dhe të paguara nga ana e përdoruesit në shumë prej 50% të vlerës së shpenzimeve të miratuara/të pranueshme për investime. Masa e bashkëfinancimit rritet deri në 55%, 60% dhe 65% në raste kur:

- 55% e vlerës së investimit të miratuar, për investimet e paraqitura nga një zotërues i një ekonomie bujqësore nga moshja 18 vjeç deri në 40 vjeç në ditën e paraqitjes së investimit ose një grua zotëruese e një ekonomie bujqësore;

- 60% e vlerës së investimit të miratuar, për investime në një ekonomi bujqësore që ndodhet në një zonë rurale kodrinore-malore;

- 65% e vlerës së investimit të miratuar, për investime të parashtruara nga zotërues të ekonomisë bujqësore prej 18 vjeç deri në 40 vjeç të ditës së parashtrimit ose një gruaje zotëruese e ekonomisë bujqësore që gjendet në një zonë rurale kodrinore-malore.

Përkrahja e ndarë financiare është paktyeshme.

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat për secilën nënpikë veç e veç parashtrihen në origjinal.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkuarit të mjeteve janë përcaktuar në Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2022 ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr. 37/22 dhe 274/22).

Nëse në Agjenci dorëzohen më shumë kërkesa sesa ka mjete në disponim në pajtim me Programin për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2022, Agjencia do tu japë përparësi atyre kërkuarësve që kanë dorëzuar kërkesën e tyre më herët se të tjerët.

Kërkuarët nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të kontratës për bashkëfinancim me Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Formularët "Kërkesë për pagesë" dhe "Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve" (Formular PRA-A1) së bashku me listën e dokumenteve të nevojshme dhe Udhëzimin e shfrytëzuesve mund të merren në ueb faqen e Agjencisë www.ipardpa.gov.mk.

në pjesën peshkataria dhe akuakultura 2022

Formularët e lartpërmendur mund të merren dhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,

Bul. "3-ta Makedonska Brigada" nr. 20

(ndërtesa e Makedonija Tabak blloku C)

1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesat e plotësuar për përkrahje financiare dhe pagesën e mjeteve nga Programi për përkrahje financiare në peshkatari dhe akuakulturë për vitin 2022 së bashku me tërë dokumentacionin e duhur dorëzohen në gjuhën maqedonase në zarf të mbyllur me shënim në këndin e majtë lart të anës së përparme të zarfit "MOS E HAP" për Thirrjen publike nr. 03/2022 dhe shënimin e shifrës së nënpikës për të cilën dorëzohet kërkesa. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë. Nëse zarfi nuk është i shënuar ashtu siç kërkohet, Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrijten jo në kohë ose të pakompletuar për arrijten në arkiv apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati i fundit për dorëzimin e kërkesave është 31.01.2023.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren në shqyrtim.

Informata më të detajuara në kontakt telefonin (02) 3097-460 ose në kontakt e-mail adresë:

ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për miratimin e projekteve dhe Sektori për miratimin e pagesës.

Telefoni: 02/3097-460, çdo ditë pune prej 08.30 deri më ora 16.30.

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL